



Prishtinë: 02.09.2021

Kodi i ZRRE-së: V\_1376\_2021

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_2192\_06\_21** i dt.22.03.2021;
- Kundërshtimi i KESCO-s i datës **15.07.2021**;

në seancën e mbajtur më datë **02.09.2021** nxori këtë:

### V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kundërshtimi i KESCO-s ndaj vendimit të DMK-së, për konsumatorin S.Q nga Komuna e Prishtinës, me shifër të konsumatorit DPR - 90090403, si e pabazuar.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK\_V\_2192\_06\_21, i datës 22.03.2021.

### A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 16.04.2021 ka marrë Vendim me nr. ZRrE/DMK\_V\_2192\_04\_21 me të cilin e ka aprovuar pjesërisht ankesën e konsumatorit S.Q, nga Komuna e Prishtinës dhe e ka obliguar të Licencuarin KESCO që ta korrigjoj faturën e dt.23.11.2013 në vlerë prej -578.15€.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, i licencuari KESCO, brenda afatit ligjor ka paraqitur Kundërshtim në Bordin e ZRrE-së, për këto shkaqe:

- Konsumatori ka qenë i kyçur ilegalisht pa pëlqimin e OSSh-së dhe se shpërndarja e faturimit për periudhën 11/2013 do të mund të bëhet duke u bazuar në Procedurën për Identifikimin dhe Parandalimin e Shfrytëzimit të Paautorizuar të Energjisë Elektrike;
- Arsyetimi i Vendimit të ZRrE-së se në periudhën 12/2013 deri me 05/2014 mesatarja mujore e shpenzimit është prej 878 kWh dhe që ky shpenzim është krijuar për periudhën 18 mujore, nuk është dëshmi reale reale se shpenzimi është bërë për periudhën 18 mujore;
- Konsumatori për disa periudha me radhë ka shpenzuar mbi 1,000 kWh;



- Mesatarja e shpenzimit prej 878 kWh/muaj nuk mund të merret si e saktë dhe reale sepse kyçja e konsumatorit ka qenë ilegale dhe pa pranim të instalimit elektrik.
- Apeluasi KESCO kërkon nga Bordi i ZRRE-së që pezullojnë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK\_V\_2192\_06\_21 i datës 22.03.2021 për konsumatorin S.Q.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 02.09.2021 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pikën e kundërshtimit të KESCO-s në të cilën pretendohet që konsumatori ka bërë kyçje ilegale dhe ka krijuar shpenzim të paautorizuar të energjisë, Bordi i ZRRE-së thekson se ky argument nuk është relevant në rastin konkret, pasi që **shfrytëzimi i paautorizuar i energjisë elektrike është vepër penale** sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, respektivisht në kapitullin e XXVI – Vjedhja e Shërbimeve, neni 314, një veprim i tillë është i inkriminuar si vepër penale. Rrjedhimisht, ZRRE nuk ka kompetencë në trajtimin e këtyre rasteve, pasi që për vepra penale, kompetente janë institucionet tjera të sistemit të drejtësisë. Bordi sqaron se bazuar në nenin 4, par. 2 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë, konstaton se për rastet që kanë elemente të veprës penale, ZRRE nuk ka mandat ligjor për të shqyrtuar ankesën e konsumatorit. Neni 4 i Rregullës së lartpërmendur parashihet që: *“Çdo ankesë ose kontest që lidhet me elementet e veprës penale, vjedhjes së energjisë elektrike, të përcaktuara në nenin 61 të Ligjit për Energji Elektrike, si dhe me dispozitat ligjore siç përcaktohen në Kapitullin e XXVI të Kodit Penal – Veprat Penale kundër Shërbimeve Komunale, ku përfshihen edhe vjedhja e energjisë termike (ngrohja qendrore) janë nën juridiksionin e gjykatës kompetente, andaj, këto ankesa ose konteste nuk trajtohen në këtë rregull”.*

Lidhur me pretendimin e KESCO-s se bazuar në procesverbalin nr.0525836 të dt.23.10.2013, se konsumatori ka qenë i shkyçur pasi që ishte kyçur ilegalisht, Bordi thekson se, ky procesverbal nuk është bashkëngjitur në shkresat e lëndës dhe si i tillë nuk mund të konsiderohet si i qëndrueshëm. Për më tepër, konsumatori S.Q, me datë 23.11.2013 i ishte hapur shifra me nr.DPR-90090403 dhe një gjë e tillë është lehtësisht e provueshme përmes faturës me nr.102-DPR13S165385 në vlerën prej 87 EUR si taksë për shërbime për lidhje të re, e ngarkuar nga Departamenti i Faturimit në KESCO. Ndërsa me datë 04.12.2013 KESCO i dërgon konsumatorit faturën e energjisë elektrike prej 15,871 kWh apo a shprehur në vlerë financiare prej 1,645.20 EUR.

Për më tepër, edhe në Përgjigjen e lëshuar nga KESCO të dt. 29.12.2018 është evidentuar se njehsori është lexuar rregullisht, dhe se edhe në muajt paraprak leximi është kontinual.

Bazuar në rrjedhën e energjisë elektrike në periudhën nëntor 2013 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë bërë pranimin teknik për njehsori elektrik nr.45044535 me gjendje me gjendje TL=15,871 kWh dhe TU=000000 kWh. Sipas të dhënave të evidentuara në programin e faturimit (ang. Customer Care Package) vërtetohet se njehsori elektrik i regjistruar ka pasur të regjistruar shpenzim – kWh, e që kjo nënkupton se është



vendosur për matje nga konsumatori para regjistrimit në KEDS/KESCO dhe se të gjithë kilovatorë - kWh e grumbulluar janë faturuar në një fature të vetme.

Po ashtu, Bordi i ZRrE-së ka analizuar rrjedhën e energjisë elektrike dhe listat e leximit të KEDS nga fillimi dhe konstaton se lexuesi i KEDS-it ka bërë inspektim dhe lexime të rregullta mujore. DMK ka analizuar shpenzimin e konsumatorit për periudhën prej 12/2013 deri në periudhën 05/2021 dhe rezulton se mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike të kësaj periudhe është 878 kWh/muaj.

Deri tek ky konstatim, Bordi i ZRrE-së ka ardhur duke administruar provat si në vijim: faturën nr.102-DPR13S165385 të dt.23.11.2013 dhe nr.11130DPR-90090403 e dt. 23.11.2013, rrjedhën e energjisë elektrike, ankesën e konsumatorit në KESCO të dt.13.12.2018 dhe ankesën e konsumatorit në DMK të dt.26.03.2019.

Pra, nga sa u tha më sipër, shihet qartë që shpenzimi i energjisë elektrike i konsumatorit i faturuar në periudhën 12/2013 prej 15,871 kWh si shpenzim mujor, nuk përputhet as për së afërmi me shpenzimin e konsumatorit të periudhave pas kontestit.

Andaj, duke u bazuar në nenin 28 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji: **“1. Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shfrytëzuar dhe për taksat e tjera, në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme). 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Furnizuesi ose Operatori i Sistemit për konsumatorët me tarifa të rregulluara në bazë të tarifave të miratuara nga ZRRE-ja, dhe për konsumatorët e kualifikuar (me çmime të parregulluara) ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim”,** pastaj në nenin 54 të Ligjit për Energjinë Elektrike **“Pajisjet matëse për matjen e energjisë elektrike janë pronë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, siç përcaktohet në Ligjin për Energjinë”** dhe duke u bazuar në nenin 3.5.1 të Kodit të Matjes, KEDS dhe KESCO është dashur që menjëherë të bëjnë ndërrimin e njehsorit dhe të verifikojnë pikën matëse, pasi që sipas dispozitave të lartcekura, operimi dhe mirëmbajtja e sistemit të njehsorëve është përgjegjësi e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 02.09.2021 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Vendimi iu dërgohet:**

- KESCO-së,
- Konsumatorit S.Q. dhe,
- Arkivit të ZRRE-së

**Bordi i ZRRE-së:**

\_\_\_\_\_  
Ymer Fejzullahu, Kryesues

\_\_\_\_\_  
Selman Hoti, anëtar

\_\_\_\_\_  
Izet Rushiti, anëtar

\_\_\_\_\_  
Lutfije Dervishi, anëtare

\_\_\_\_\_  
Gani Buçaj, anëtar